

A K T T H E M E L U E S

I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE “LALA” SH.P.K.

Une **Skender Lala**, i biri i Syflos, datlindja 1964, lindur e banues ne Has. Mbeshtetur ne nenin 251, shkronja “c”, te Ligjt Nr.7512 date 10.08.1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit”, krijoj shoqerine tregetare private me perjegjesi te kufizuar te quajtur “**LALA**” dhe me aktin themelues te saj si vijon:

F O R M I M I

NENI 1

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur “**LALA**” sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

VEND-QENDRIMI I SHOQERISE

NENI 2

Vend-qendrimi i shoqerise tregetare private “**LALA**” sh.p.k. do te jetë ne Has.

Shoqeria do te hape edhe vend-qendrime te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi, ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e:

1- Tregetimit me shumice dhe pakice dhe import eksport te:

- Mallra te ndryshme industriale, ushqimore, konfeksione, elektro-shtepiake, hidro-sanitare, etj.
- Mobilje orendi shtepiake, kinkaleri-kanceleri, vegla pune, paisje te ndryshme, etj.
- Mallra te ndryshme bujqesore, blegtoriale, bime medicinale e mjekesore.

2- Transport mallra brenda e jashte vendit.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi perpunimi e sherbimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jetë me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkaku.



KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise tregetare private “**LALA**” sh.p.k. do te jetë 100.000 leke. dhe do te perbehet nga kuota e ortakut themelues te shoqerise.

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakut themelues. Kapitali eshte teresish i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

NENI 7

Ortaku i vetem duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruaje sekretin e saj dhe te mos demtoje interesat e personave te tjere dhe te shoqerise.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, ortaku themelues i shoqerise, z.**Skender Lala**.

NENI 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut themelues te shoqerise.

NENI 10

Ortaku themelues ka te drejte te emeroje edhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise.

Ai ka te drejte te caktoje financier, likuidator per problemet e shoqerise, si edhe te pajtojne persona te tjere si ortake.

Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

NENI 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykojn ne Gjykatene e Rrethit Tirane, sipas statutit te shoqerise, kontrates se lidhur me palet dhe ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakoneshme, me tekstin per rrethin e saj.

NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 “Mbi krijimin e shoqerive tregetare”.



NENI 14

Ky akti i themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kopetente.

NENI 15

Akti i themelimit, u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe një kopje do te mbeten ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private “**LALA**” sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“ **LALA** ” sh.p.k.

Skender Lala



S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “LALA”

Ne baze te ligjit 7512 date 10.08.1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit” dhe te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, “Per shoqerite tregetare”, me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit Themelues:

Une **Skender Lala**, i biri i Sylejdos, datlindja 1964, lindur e banues ne Has.

Hartoj Statutin e shoqerise si me poshte:

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

Shoqeria emertohet “**LALA**” sh.p.k.

NENI 2

Selia e shoqerise tregetare private “**LALA**” sh.p.k. do te jete ne Has.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregetar, prane Gjykates se Rrethit Tirane.

NENI 4

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e:

- 1- Tregetimit me shumice dhe pakice dhe import eksport te:
 - Mallra te ndryshme industriale, ushqimore, konfeksione, elektro-shtepiake, hidro-sanitare, etj.
 - Mobilje orendi shtepiake, kinkaleri-kanceleri, vegla pune, paisje te ndryshme, etj.
 - Mallra te ndryshme bujqesore, blegtorale, bime medicinale e mjekesore.
- 2- Transport mallra brenda e jashte vendit.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise tregetare private “**LALA**” sh.p.k. do te jete 100.000 leke. Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakut themelues te shoqerise. Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakut themelues te shoqerise. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

NENI 6

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te lujteshme ose te palujteshme etj, te nevojeshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 7

Kuota e kapitalit fillestar eshte derdhur nga ortaku themelues ne Banke, ne llogarine bankare te shoqerise, si edhe te regjistruara ne librin e llogarise te shoqerise.

NENI 8

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, i takojne ortakut themelues, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

NENI 9

Shoqeria tregetare “**LALA**” sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria tregetare “**LALA**” sh.p.k. gezon te drejta, sikunder çdo person tjeter juridik, shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 10

Shoqeria tregetare “**LALA**” sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj.

Ortaku themelues i shoqerise mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 11

Shoqeria do te drejtohet nga ortaku themelues i shoqerise, z.**Skender Lala**.

NENI 12

Hyjne brenda detyrave dhe kopetencave te ortakut themelues si me poshte:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe i bilancit e llogarise vjetore.
3. Zgjedhja e administratorave jo-ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kopetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe Shenohen ne statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i tarifave per sherbimet qe kryen shoqeria.
6. Pranimet ne pune dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i formes se vules dalluese te shoqerise.
8. Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te Shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.

NENI 13

Administratori jo ortak perveç detyrave qe i caktojne ortaket e shoqerise ka edhe keto detyra e te drejta:

1. Te mire-administroje pasurine e shoqerise.
2. Te beje marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kopetencave te caktuara nga ortaku themelues.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshme te shoqerise.
4. Te per gjigjet per demet qe i sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te marreveshjes te bere me ortakun themelues.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithcka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

NENI 14

Shoqeria ka te drejte:

1. Te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punetore te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

NENI 15

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur.
2. Te jape garanci per sherbimet qe kryen shoqeria.
3. Te siguroje punonjesit e saj.
4. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilidto.
5. Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

NENI 16

E gjitha veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

NENI 17

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni finanziar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

NENI 18

Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

NENI 19

Shoqeria imban xhiro-llogarite ne Banken Kombetare Tregetare Shqiptare. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

NENI 20

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financier, shoqeria, pasi ben zbritjet e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5 % te fitimit, me te cilin krijohet fondi “Rezerve e domosdoshme”, deri sa ky fond te arrije ne masen 10 % te kapitalit themeltar.

NENI 21

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondev te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, i mbesin ne perdom ortakut themelues te shoqerise. Konvertimi i parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e Shtetit shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

DISPOZITA TE VEÇANTA

NENI 22

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

NENI 23

Shndrrimi i shoqerise “**LALA**” sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te ortakut themelues.

NENI 24

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkaku, si:

- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese se ortakeve

Ne keto raste, pronari i shoqerise vendos mbi menyren e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.

Administratori dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise per derisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizik e juridik, duke likuiduar ne rradhje te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria.

Ne rast se fondet disponibel, rezultojne te pamjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe i takojne atij.



DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 25

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaku themelues, si edhe ligjeve te veçanta te legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen me menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.

NENI 26

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private “**LALA**” sh.p.k.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“ **LALA** ” sh.p.k.

Skender Lala



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA E TIRANES

Nr.....Rep 1740

Tirane me 27.2.1998

Nr.....Kol 165

V E R T E T I M

Vertetohet se Statuti i Shoqerise tregetare private “**LALA**” sh.p.k. nenshkruhet prej ortakut themelues z. **Skender Lala**, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leter-njoftimi, ne prezencen time dhe une notere duke e gjetur ate te rregullt e nenshkruaj si me poshte.

